

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pensionet shqiptare në Itali, diaspora i kërkon Ramës heqjen e tatimit nga qeveria italiane
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/pensionet-shqiptare-ne-itali-diaspora-i-kerkon-rames-heqjen-e-tatimit-n-i585615
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 13:15:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 14:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9f0976af5e74cdb73809501cb0ed3dd5e24d7ac4c11a0ba34c42648ab0d36530
TEKSTI	909b50f1e1962cc02565e986b87f423c9f3755ae667c4420a10c39ef56914158
PAMJA	e91ebe8cd56dc900f2aa111a3722afb0568e5f454f26bcc4fff92b4a6dbd7c1b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	034360c1b138d664e0cceab3c8133ebfb4b20f1e47384060ed3b98f276980532
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/034360c1b138d664e0cceab3c8133ebfb4b20f1e47384060ed3b98f276980532>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1 e 'Det' pjesemarrësish në "Marshin për liri" në Prishtinë: Mungojnë Albin Kurti dhe... PDDokumentari për Gazën "NAZA" mahnit VenecianKama, mesazh administratës: Ç'do shkelje afati, duhet të fundit

Pensionet shqiptare në Itali, diaspora i kërkon Ramës heqjen e tatimit nga qeveria italiane

12 Shtator 2026, 16:30Politika TEMA



Pensionet shqiptare në Itali, diaspora i kërkon Ramës heqjen e

Përfaqësues të diasporës shqiptare në Itali i kanë kërkuar kryeministrit Edi Rama nisjen e një dialogu institucional me autoritetet italiane për trajtimin tatimor të pensioneve shqiptare që përfitohen nga qytetarët me rezidencë fiskale në Itali.

Kërkesa është paraqitur nga grupi “Pension – Dinjitet – Unitet” dhe shoqata “Diaspora 91-19 ANIAP”, të cilat argumentojnë se pensionet shqiptare, shpesh në nivele të ulëta, përfshihen në bazën e tatueshme të përfituesve në Itali.

Sipas kërkesës, nga 1 korriku 2025 është në fuqi Marrëveshja Shqipëri–Itali për sigurimet shoqërore, e cila koordinon periudhat e sigurimit dhe njeh të drejtën e pensionit të krijuar nga kontributet në të dy vendet.

Përfaqësuesit e diasporës i referohen gjithashtu Konventës mes Shqipërisë dhe Italisë për shmangien e tatimit të dyfishtë, duke argumentuar se pensionet që lidhen me një punësim të mëparshëm taten në shtetin ku përfituesi ka rezidencën fiskale.

Sipas tyre, një qytetar që jeton në Itali dhe përfiton një pension shqiptar prej rreth 100–150 eurosh në muaj duhet ta deklarojë këtë shumë në Itali, ku ajo i shtohet të ardhurave të tjera dhe taten sipas sistemit progresiv italian IRPEF. Tatimi sipas ligjeve italiane arrin deri 20%.

Në kërkesën drejtuar qeverisë shqiptare argumentohet se kjo krijon një barrë të ndjeshme për pensione relativisht të ulëta dhe kërkohet që trajtimi fiskal të marrë në konsideratë nivelin e të ardhurave dhe kapacitetin real kontribues të pensionistëve.

Përfaqësuesit e diasporës kërkojnë që Tirana zyrtare të negociojë me palën italiane mundësinë e një protokolli shtesë ose një marrëveshjeje që të trajtojë në mënyrë specifike pensionet e ulëta shqiptare të përfituara në Itali.

Mes propozimeve është edhe krijimi i një trajtimi më të favorshëm për pensionet shqiptare nën një prag të caktuar vjetor, si dhe shqyrtimi i një forme tatimi të reduktuar për pensionet minimale të huaja.

Ata kërkojnë gjithashtu ngritjen e një tryeze të përbashkët Shqipëri–Itali me përfaqësues të institucioneve fiskale, sigurimeve shoqërore, diasporës dhe strukturave që asistojnë pensionistët.

“Një pension prej 100–150 eurosh në muaj nuk është pasuri, është njohja minimale e një jete pune të kryer në Shqipëri”, thuhet në kërkesën e firmosur nga përfaqësuesit e “Pension – Dinjitet – Unitet” dhe “Diaspora 91-19 ANIAP”.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama, mesazh administratës: Çdo shkelje afati, duhet të ketë përgjegjësi dhe kosto](#)

15:10 Politika

[“Drejtësia po godet rendin kushtetues”, Çupi: Gjyqësori në Shqipëri është mësuar me para në xhep](#)

13:10 Politika

[SHBA zyrtarizojnë huanë 302 milionë dollarë për Shqipërinë](#)

13:00 Politika

[Beteja e fundit për ish-krerët e UÇK! Rama: Liri për çlirimtarët, Thaçi do të triumfojë me forcën e së vërtetës](#)

11:10 Politika / 2 komente

[VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku e gjeti, nuk e solli!](#)

10:02 Politika

[“Rrezikohet besimi te drejtësia”, Leka: Absurde që gjyqtarët dhe prokurorët të rrisin vetë pagat e tyre](#)

07:51 Politika / 7 komente

[“Prania Besnike”/ Rama pas takimit me qytetarët në Shkozë: Eksperiencë krejt ndryshe nga çdo gjë që kam jetuar në politikë](#)

23:03 Politika / 6 komente

["Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agasit: Secili përballlet me ligjin me veten dhe avokatin e vet](#)

22:46 Politika / 28 komente

[Braçe sulmon gjyqtarët pas kallëzimit të Malajt në SPAK: Vetëgjyqësi, po kalojnë në harbim](#)

22:22 Politika / 12 komente

[“Të mbash kryetarin e kryeqytetit në qeli është absurd”, Rama: Tirana po vuan mungesën e drejtimit](#)

21:33 Politika / 44 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë

16:18 Politika / 48 komente

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro ...

13:45 Sociale / 3 komente

"Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agas...

22:46 Politika / 28 komente

Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare

17:00 Editorial / 20 komente

"Për dosjet e qytetarëve vite pritje, për pagat e veta Gj...

16:23 Politika / 51 komente

Blog Tema

Unë jam me Petrit Malajn

14:45 Blog

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

11:40 Blog / 11 komente

Haga, midis maktheve dhe paranojave

21:00 Blog / 1 koment

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm• Kontakt• Te dhënat personale• Cookies | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
|---|--|

Built and Monetized by